



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 213 Prot.

Tiranë, më datë 21.03.2025

VENDIM

Nr. 194, datë 21.03.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.03.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesë për *“Raportin e Verifikimit në terren në kuadër të evidentimit të mbetjeve skeletore njerëzore pranë kishës së Shën Nikollës, lagja Kala Berat”*, hartuar nga **Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik në IKTK** në bashkëpunim me **DRTK Berat, me rekomandimin;**
 - Të realizohet dokumentimi dhe heqja e mbetjeve skeletore nga dritarja e absidës së kishës së Shën Nikollës nga DSHA dhe DRTK-Berat.
 - Të realizohen 2 sondazhe arkeologjike në pjesën e mbetur të mbushjes mes kishës e rrugës, dhe në hapërrirën ku ka qenë paraklisi i shën Andonit, në të djathtë të hyrjes së kishës, me qëllim sqarimin e stratigrafisë dhe përmbajtjen e saj.
 2. Rezultati i sondazheve arkeologjike dhe dokumentimit të varrit, të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje në KKTKM-së.
 3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
 5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim lryn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Joli MITROJORGJI

